

Dashmir Idrizi, PhD¹

UDC: 316.774:323.1(497.7)
316.774:316.722(497.7)

**ROLI I MEDIAVE NË RUAJTJEN E IDENTITETIT KULTUROR NË
REPUBLIKËN E MAQEDONISË SË VERIUT**

**УЛОГАТА НА МЕДИУМИТЕ ВО ЗАЧУВУВАЊЕТО НА КУЛТУРНИОТ
ИДЕНТИТЕТ ВО РЕПУБЛИКА СЕВЕРНА МАКЕДОНИЈА**

**THE ROLE OF THE MEDIA IN PRESERVING CULTURAL IDENTITY
IN THE REPUBLIC OF NORTH MACEDONIA**

Abstract

Media in the 21st century represents an apocalyptic shift from the previous century, as the internet has significantly changed the way media operates and its impact on the public, considering the massive influence of social networks and various sources used for obtaining information.

Based on the information we have and the ongoing developments regarding media influence in the era of globalization-particularly its impact on national identity in the Republic of North Macedonia, where tolerance and conflicts are visible and inevitable for part of the population-it is essential to take immediate measures to preserve identity from degeneration. This is especially noticeable in Macedonian-language media, such as TV Alfa and Sitel, not to mention various online portals in the same language.

Even more concerning is the evident presence of hate speech among Macedonian politicians, including opposition figures such as "Levica" (The Left) and representatives of the Macedonian party participating in the Government of North Macedonia, "Znam." This issue became particularly evident on November 28, 2024, when a group of Macedonian hooligans desecrated the Albanian national flag.

After November 28, several Albanian citizens were arrested in Skopje simply for raising the Albanian national flag. Meanwhile, some Macedonian citizens were arrested in the city of Manastir for desecrating the same flag!

¹ University of Tetovo Faculty of Law-Journalism, Email: dashmir.idrizi@unite.edu.mk

All of this was a result of incitement and misinformation spread by Macedonian media.

Although media influence is immense on the population of the country we live in, the question arises: Are we preserving our identity, or are we destroying it?

This concern is not only visible on social networks, which lack control over their publications, but also in the content broadcasted by national and even satellite media. Programs such as Përputhen, Big Brother, aired on channels like Top Channel, Klan Kosova, and T7, are contributing to the moral and cultural degeneration of society.

The opinion of citizens is extremely important when it comes to interethnic relations, national identity, and their overall lives.

Keywords: *identity, culture, media, challenge, degeneration...*

Hyrje

Media në shekullin XXI paraqet një epokë ndryshe nga shekulli i kaluar, duke marrë parasysh ndikimin masiv të popullatës nga rrjetet sociale, burime të ndryshme që i shfrytëzojnë për marrje të informacioneve, me një fjalë interneti ka ndryshuar shumë mënyrën dhe ndikimin e mediave tek publiku.

Ky punim është bazuar në informacione dhe hulumtime rreth çështjes së ndikimit të mediave në kohën e globalizmit, në identitetin kombëtar në vendin tonë, pra në Republikën e Maqedonisë së Veriut, ku toleranca dhe konfliktet janë të dukshme dhe të pashmangshme për një pjesë të popullatës.

Edhe pse ndikimi i medias është shumë i madh për popullsinë e shtetit ku jetojmë kemi marrë parasysh edhe mendimin e vet qytetarëve me anë të anketimit për të mbledhur informacione sa më të sakta rreth kësaj çështje. Mendimi i qytetarëve është shumë i rëndësishëm kur bëhet fjalë për marrëdhëniet ndëretnike, identitetin ndërkombëtar si dhe jetën e tyre në tërësi.

Në vijim do të mundohemi që të bëjmë një krahasim sa i përket raportimit të mediave maqedonase dhe atyre shqiptare, cilat janë më të singërtat në raportim, kur e dimë se RMV-ja është një shtet multi-etnik.

Koncepti mbi identitetin kombëtar

Në vështrim të përgjithshëm, me identitet nënkuptojmë veçantitë apo tiparet që ka një send, të cilat nuk ndeshen bashkërisht në sendet e tjera. Në gjirin e shoqërisë njerëzore çdo hallkë e saj ka identitetin e vet, i cili mund të jetë fizik, moral, kulturor, juridik e politik. Kështu për shembull, njeriu, qenia bazë e shoqërisë njerëzore, burrë ose grua qoftë, ka si tipar themelor identitetin fizik, në vështrimin antropologjik, pra veçori thjesht personale që nuk ndeshen

të gjitha së bashku tek qeniet e tjera: emri, mbiemri, vendlindja, datëlindja, atësia, amësia, seksi, lartësia trupore, ngjyra e lëkurës, e flokëve, e syve, defektet fizike dhe kohët e fundit shenjat e gishtërinjve ose shenjat biometrike. Në të njëjtën kohë po ajo qenie njerëzore ka edhe identitetin e vet kulturor e qytetar, me të cilin nënkuptohen: gjuha amtare, arsimit i kryer, përkatësia etnike, qytetaria shtetërore, në disa raste (por jo kurdoherë) edhe përkatësia fetare, etj., të cilat edhe pse janë përkatësi personale, nuk hyjnë në qerthullin e identitetit të mirëfilltë, mbasi ndeshen edhe në qenie të tjera të shoqërive njerëzore.

Çdo komb përfaqësohet me identitetin e vet kombëtar, i cili në thelb është një identitet kulturor dhe qytetar, me komponentë të tillë siç janë gjuha e banorëve, trashëgimia historike, kultura popullore, mentaliteti shoqëror, mënyra e jetesës, e drejta e pashkruar, por siç u tha dhe siç do të shtjellohet më hollësisht më tej.²

Kur identiteti ndërtohet në bazë të etnosit, ai reduktohet në identifikim me grupin etnik, gjë që shkakton kufizim dhe ngushtim qoftë për individualitetin, qoftë për identitetin grupor, që duhet t'i nënshtrohet etnicitetit, që përbën identifikimin e plotë me grupin etnik. Kështu, "uni" i individit dhe i grupit vjen duke u varfëruar.

Te kombi si bashkësi kulturore/politike, identifikimi kombëtar paraqet vetëm fazën e parë të domosdoshme, që nënkupton kategorizimin e individit në një bashkësi të caktuar politike, por jo në plan të gjerë në kuadër të një kulture dhe sistemi shoqëror-politik. Ama, identifikimi kombëtar nuk është kusht i mjaftueshëm për integrimin vetjak dhe social, pasi në shoqërinë bashkëkohore ka pluralitet procesesh identifikimi. Prandaj, gjatë zhvillimit të personit shfaqet qasja refleksive dhe kritike ndaj objekteve të identifikimit. Qasja kritike i mundëson individit të arrijë pavarësi dhe mëvetësi (veçanti), kështu që nuk kemi ndonjë shenjë barazimi mes identifikimit kombëtar dhe identitetit vetjak/kolektiv. Në këtë rast rregulli: sa më të përpiktë të jenë identitetet vetjakë dhe gruporë, aq më fleksibël do të jetë identifikimi me kombin.³

Sa ndikojnë mediat në informimin/dezinformimin e opinionit?

Mediat janë arma më e fortë e fuqive të mëdha. Nëpërmjet tyre, ata ndikojnë në fuqishëm në mënyrën e jetës së njerëzve, në nxitjen apo shuarjen e konflikteve në vende të ndryshme të botës. Ata kanë ndikim edhe në luftë edhe në paqe, përdoren edhe për të shuar mosmarrëveshje reale edhe për të nxitur konflikte ireale. Këto pikëpamje nuk janë të panjohura nga masat e gjëra popullore, por ata gjithmonë bien në grackat mediatike. Sot zhvillimi i mediave të reja së bashku me benefitet e tyre mundësojnë ndërhyrjen edhe në vlerat më të larta njerëzore.

² Prof. Dr. Kristo Frashëri, Identiteti kombëtar shqipëtar dhe çështje të tjera, Titanë, 2006.

³ Unë dhe tjetri, Zagorka Golubović, Beograd, 1999.

Rrjedhat e sotshme globale, në aspektin social dhe shpirtëror janë duke krijuar kushte të favorshme për ndërhyrje në identitetin e njeriut.

Shoqëritë demokratike sot janë në kulmin e zhvillimit, si në aspektin material ashtu edhe në atë shpirtëror. Ky duket një konstatim shumë i njëanshëm, sepse tejkalimi i problematikave tekniko-teknologjike si dhe të atyre sociale, të cilat në vazhdimësi pengonin mirëqenien njerëzore, çdo herë ka inicuar çështje të reja, të cilat për të kaluarën ishin të panjohura. Rrethanat socio-ekonomike dhe ato kulturore gjithmonë janë pjesë e cikleve të zhvillimit në përgjithësi. Aspekti kohor i ndryshimeve shoqërore varet prej shpejtësisë së përhapjes dhe distribuimit të informacionit. Përderisa në të kaluarën nevojitej kohë më e gjatë për përhapjen e ndodhive shoqërore, ose shpesh ato nuk guxonin fare të përhapeshin, rezultonte me një nënshtrim të shoqërisë ndaj gjendjeve aktuale. Ato pranoheshin si të tilla dhe nuk ndërmerrej asnjë veprim për tejkalimin e tyre. Varësisht sistemeve politike, masat e gjera popullore ndikoheshin nëpërmjet mediave, të cilat i nënshtroheshin një censure të kontrolluar në çdo detaj. Si pasojë e mos sensibilizimit të çështjeve shoqërore, shumë veprimtari mbeteshin me vite të tëra në favor të pengimit zhvillimor të shoqërisë.

Mediat çdo herë kanë luajtur rol të rëndësishëm në shoqëri, nëpërmjet tyre janë favorizuar, penguar apo shkatërruar shumë çështje shoqërore. Ato kanë arritur të ndikojnë edhe në vlerat më të rëndësishme dhe më rezistente njerëzore. Fuqia mediatike ka arritur të prekë edhe identitetin individual dhe kolektive të njeriut.⁴

Në Republikën e Maqedonisë së Veriut në media shfaqet edhe dukuria e njohur si “GJUHA E URREJTJES”, gjë që ndikon thellë në raportet në mes të nacionaliteteve në vendin tonë. Janë të rrallë ata studiues që do ta kundërshtojnë lirinë e medias, por, nga ana tjetër kjo liri nuk do të thotë se vetë media mund dhe duhet të përjashtohet nga përgjegjësia që ka.

Fatkeqësisht, koha kur mediat ndikohen nga politika vërehet më tepër kur në pushtet në RMV vjen partia nacionaliste nga pala maqedonase e që është VMRO-DPMNE. Kjo ndodhi edhe kur në vitet 2006-2016 vdiqën, u arrestuan gazetarë apo u mbyllën medime. Nxitja e urrejtjes fatkeqësisht na u paraqit edhe vitin e kaluar me rastin e festës kombëtare shqiptare 28 Nëntori (2024), festë kjo edhe pse nuk është shtetërore, por megjithatë ajo në formë të ndryshme festohet nga qytetarët shqiptarë në RMV. Fatkeqësisht 28 nëntori i vitit 2024 nuk kaloi pa probleme. Derisa në Kumanovë qytetarët maqedonas e tërhoqën nga shtylla flamurin kombëtar shqiptar (madje polic me uniformë), jo vetëm që e tërhoqi nga shtylla, por të njëjtin edhe e përdhosi, njëjtë ndodhi edhe në Manastir, pra, në të njëjtën datë huliganët maqedonas e shkelën flamurin kombëtar shqiptar, ndërsa disa djem të rinj shqiptar në Shkup e ngritën të njëjtin (e vendosën në shtyllat elektrike).

⁴ Centrum-2-2014, Revistë shkencore, Gëzim Xhambazi.

Pas këtij akti derisa mediat në gjuhën shqipe TV ALSAT, TV-21, TV SHENJA, MTV-2 raportonin për përdhosje të flamurit shqiptar, mediat në gjuhën maqedonase siç janë TV ALFA, TV-SITEL, KANAL5 dhe shumë të tjera nxitnin urrejtjen duke thënë se çka kërkojnë shqiptarët këtu të ngritin flamurin e shtetit të huaj (Shqipërisë), e të mos flasim më për publikimet-shkrimet nëpër portalet dhe rrjetet sociale të vendit të cilat nuk kanë kurrfarë kontrolli.

Një përdhosje e identitetit kombëtar vërehet madje edhe tek mediat prestigjioze në Shqipëri dhe Kosovë siç janë Top-Chanell, TV-Klan në Shqipëri si dhe TV-Klan dhe T7 në Kosovë, shikueshmëria e të cilave zë një vend të konsiderueshëm edhe në hapësirën mediatike që mbulon eterin e Maqedonisë, media këto përmes programeve të tyre shfaqin emisionet “Përputhen“, “Vëllai i madh” apo siç e quajnë ata “Big Brother” dhe emisioni “Zanat”, për të cilat mendoj se janë duke e tepruar me sjelljen dhe zhvillimet që po ndodhin nëpër këto emisione, qoftë për nga veshja, sjellja apo fjalori i komunikimit që zhvillohet përmes banorëve të cilët ngujohen nëpër këto far shtëpi.

Tentim për mos plasimin e të vërtetës ndodhi edhe pas tubimit të madh që u mbajt në sheshin “Maqedonia”, në Shkup dy ditë pas rastit makabër më 18.03.2025, pas djegies së diskotekës “Pulse” në Koçan (që ndodhi ditën e diel ora 03.00, 16 mars 2025), ku humbën jetën 59 persona kryesisht të rinj si rezultat i djegies së të njëjtës. Më pas në stacionin policor Qendër, në bisedë informative ishin ftuar kryeredaktori i TV21, Eroll Shakiri dhe gazetari dhe redaktori i lajmeve, Jovica Paunoski, transmeton TV21, si dhe disa gazetarë siç na njofton përmes një komunikate MPB e RMV-së, cit.: “Me datë 18.03.2025 në stacionin policor Qendër në Shkup është zhvilluar bisedë me S.M. (34) nga Sopishta e Shkupit, J.S.(24) nga Koçani, E.SH.(43) nga Shkupi, J.P.(28) nga Shkupi, M.D.(45) nga Shkupi, M.J. (36) nga fshati Gerishan i Manastirit dhe M.Gj. (51) nga Republika e Serbisë. Gjatë tubimit publik në sheshin “Maqedonia” në Shkup (më 18.03.2025), u kapën duke fluturuar dron pa njoftim paraprak për aktivitetin. Po ashtu në ora 19:00 në Koçan nga ana e punonjësve policorë të stacionit policor Koçan është ndaluar A.D. (38) nga Republika e Bullgarisë pasi është kapur duke operuar dhe filmuar me dron pa miratimin e duhur nga institucioni kompetent. Pas bisedave të gjithë personat janë liruar”, thonë nga MPB.

Nuk vonoi as reagimi i SPGM dhe ShGM të cilat kërkojnë shpjegim se pse gazetarët u morën në bisedë informative pa shpallje paraprake për ndalim të dronëve. Në reagim thuhej: “ShGM dhe SPGPM shprehin shqetësimin për thirrjen e gazetarëve në bisedë informative, mes të cilëve edhe përfaqësues të mediave pas protestës së mbrëmshme në Shkup. Nga ShGM thonë se sipas informacioneve të disponueshme, ndalimi i përdorimit të dronëve është shpallur zyrtarisht para orës 20:00, pothuajse dy orë pasi protesta kishte filluar tashmë. Nga SHGM hedhin dyshime edhe për mënyrën se si është sjellë vendimi për ndalim të dronëve në territorin e Shkupit, pasi siç thonë, nëse sillet një vendim i tillë, “duhet të përcaktohen saktësisht dhe të jenë të disponueshme për publikun në kohën e duhur.”

“Zbatimi i përgjithshëm i ndalimit pa njoftim paraprak dhe për një qytet të tërë, si në këtë rast, nuk është në përputhje me këtë dispozitat ligjore”, thonë më tej nga ShGM (19.03.2025).

Nuk ekziston asnjë lloj lirie, përfshirë këtu edhe lirinë e shprehjes që të jetë absolute. Ajo kufizohet nga detyra për të respektuar dinjitetin e të tjerëve dhe lirinë e tyre legjitime. Nuk duhet të shkruhen, të krijohen dhe të transmetohen programe nëse ato dëmtojnë të vërtetën: jo vetëm të vërtetën faktike që përcillet, por edhe të vërtetat rreth një qenieje njerëzore, dinjitetin e një personi në të gjitha dimensionet.

Se me të vërtetë liria e shprehjes në RMV është e kufizuar zakonisht kur në pushtet në RMV vjen partia nacionaliste nga pala maqedonase e që është VMRO-DPMNE e dëshmon edhe raporti i REPORTERËVE PA KUFIJ i cili u publikua pikërisht në ditën e lirisë së shprehjes me 3 maj 2025 ku thuhet se: “Maqedonia ra për 6 vende, nga vendi i 36-të në të 42-tin, në Indeksin e Lirisë së Shtypit të Reporterëve pa Kufij (RSF), dhe është e fundit në grupin e vendeve ku situata është “e kënaqshme”. Në këtë grup nga rajoni janë vetëm edhe 2 vende, Sllovenia, e cila është ngjitur me 9 vende në vendin e 33-të, dhe Mali i Zi, i cili është ngjitur me 3 vende në vendin e 37-të, dhe të gjitha të tjerat janë në grupet me një situatë “problematiche” ose “të vështirë”. Klasifikimi i RSF-së mbulon 180 vende anembanë botës”.

Studiues të ndryshëm kanë vënë theksin mbi konfirmimin që ndodh në mes realitetit që përcillet nga media dhe atij që ndodh në të vërtetë. Mesazhet që përcillen përmes medias, në rastin konkret përmes ekranit të televizionit, shpeshherë nxisin realitete artificiale për njerëz që vijnë dhe që u përkasin formimeve të ndryshme socio-kulturore. Këto realitete artificiale varen nga aktorë të ndryshëm, duke nisur nga politikantë redaksionale të medias, e deri tek personalizimi apo qëllimi që mund të ketë edhe vetë gazetari që raporton, por pse jo edhe nga botëkuptimi (interpretimi, keqkuptimi, aftësitë) që grupe të caktuara shoqërore mund të shfaqin në lidhje me historitë e trajtuara përmes medias. Të ekspozuar përballë këtyre imazheve, te audienca arrijnë deri në atë pikë sa të mos bëjnë dallime midis realitetit që paraqitet në ekran dhe atij që është në të vërtetë. Përgjithësisht triumfon realiteti artificial i ndërtuar përmes përmbajtjeve që burojnë nga media. Nëse do të analizonim këtë ndikim duke iu referuar efekteve që mund të ketë gjuha e urrejtjes që buron nga media, mund të themi se kjo qasje mund të krijojë realitete artificiale të urrejtjes, të cilët me kalimin e kohës dhe përmes proceseve të ndryshme mediatike mund të sjellin pasoja të mëdha sociale dhe të përshkallëzuara.

Gjuha e urrejtjes përmes mediave ka ndikuar shumë në raportet mes kombeve në Maqedoninë e Veriut, kjo dukuri fatkeqësisht mbizotëron dhe reflekton negativisht në jetën tonë. Identiteti kombëtar në Maqedoninë e Veriut ndikohet negativisht nga mediat pikërisht duke përdorur gjuhën e urrejtjes, që shkakton shpesh herë konflikte në mes palëve apo kombësive të ndryshme.

Analiza e rezultateve të hulumtimit mbi çështjen ndikimi i medias në kohën e globalizmit në identitetin kombëtar në Maqedoninë e Veriut

Analizë nga anketimi

Për të analizuar më thellë këtë çështje, dhe për ta pasur më të qartë se si vetë qytetarët e Republikës së Maqedonisë së Veriut ndjehen në rrethanat që jetojnë, ne bëmë një analizë nëpërmjet një ankete. Anketa pati disa pyetje rreth asaj se si mendojnë qytetarët për ndikimin e medias në kohën e globalizmit në identitetin kombëtar. U anketuan gjithsej 70 qytetar të rrethinës së qytetit të Tetovës, ku morën pjesë 50 shqiptarë dhe 20 maqedonas. Të cilët u përgjigjën anketës sonë, mirëpo ne kemi veçuar disa nga përgjigjet e tyre!

Anketën do të mund ta shihni në fund të këtij punimi, mirëpo për rezultatet e grumbulluara do të japim sqarim nëpërmjet tabelave dhe grafikoneve në vijim.

Ndikimi i medias globale në identitetin kombëtar


Pyetjet më të rëndësishme që na interesonin ishin se si mendojnë qytetarët; se a ka ndikim media globale në identitetin kombëtar. Kjo pra ishte pyetja e parë që u parashtrua rreth temës, dhe si përfundim nga përgjigjet e anketuesve mund të themi se, shqiptarët janë të mendimit se media globale ka ndikim në ruajtjen e identitetin kombëtar ku nga 50 të anketuar 31 ishin të mendimit se ka ndikim, pjesërisht u përgjigjën 16 anketues, ndërsa me jo u përgjigjën vetëm 3 anketues shqiptarë. Nga pala maqedonase edhe pse u pajtuan ta plotësonin anketën vetëm 20 qytetarë, me po dhe pjesërisht u përgjigjën nga 6 po dhe 6 pjesërisht, ndërsa me jo u përgjigjën 8 anketues (e sqaruar në grafikonin 1.)



Grafikoni 1.

Informacionet e mediave vendase

Në pyetjen e 7-të me radhë të anketës u parashtrua pyetja; Sa mendoni se mediat vendase japin informacione të sakta, dhe kjo pyetje ishte mjaft me rëndësi shkaku i besimit të qytetarëve në mediat vendase, dhe se sa besim ato kanë në atë që shohin, dëgjojnë dhe e kërkojnë nga mediat. Edhe pala shqiptare edhe ajo maqedonase u përcaktuan më së shumti në përgjigjen ndonjëherë, që do me thënë se nuk janë edhe aq të sigurt se mediat në Maqedoninë e Veriut japin çdoherë informacione të sakta, çdoherë u përgjigjen 6 shqiptarë dhe 6 maqedonas, ndërsa me përgjigjen varet u përgjigjen 25 shqiptarë dhe 5 maqedonas (e sqaruar në grafikonin 2.).




Grafikoni 2.

Ndikimi i medias në nxitjen e urrejtjes ndërnacionale në Maqedoninë e Veriut

Meqë e dimë se në Maqedoninë e Veriut ka pasur zënka të shpeshta në mes të nacionaliteteve të ndryshme, e veçanërisht në mes të tifo-grupeve sportive dhe si më e shpeshta kanë qenë në mes shqiptarëve dhe maqedonasve, si para konfliktit të vitit 2001 po ashtu edhe pas konfliktit, gjë që ka shtuar në disa raste edhe urrejtjen ndaj të dyja palëve. Shumica e konsiderojnë se mediat vendase janë shkaktarë të këtyre zënkave ose thënë ndryshe nxitëse të përleshjeve të shumta. Edhe pse kjo anketë u pranua nga shqiptarët menjëherë dhe e plotësuan pa problem, pala maqedonase nuk mori pjesë me të njëjtin numër për shkak se ato refuzuan ta plotësonin edhe pse ishte e shkruar në gjuhën maqedonase. Pra, jemi të mendimit se media ka ndikim në nxitjen në mes kombeve të ndryshme, nga anketuesit shqiptarë mendonin se ka ndikim 12 anketues, ndërsa maqedonasit po ashtu 12 (meqenëse gjithsej ishin 20 anketues maqedonas), të mendimit varet: shqiptarë kishte 25, ndërsa maqedonas 4, dhe të mendimit se ndonjëherë kanë ndikim mediat në


përleshjet, shqiptarët ishin të këtij mendimi 13 anketues, ndërsa maqedonas 4 (e shfaqur në grafikoni 3.)



Grafikoni 3.

Edukimi i masës për vlerat e identitetit kulturor

Sa i përket edukimi për vlerat e identitetit kulturor në Maqedoninë e Veriut mund të themi se ka përpjekje por jo edhe të mjaftueshme. Në pyetjen e 8 të anketës u parashtua pikërisht kjo pyetje dhe morëm këto përgjigje si në vijim; përpjekje të mëdha u përgjigjën 10 shqiptarë dhe 6 maqedonas. Përpjekje të vogla 20 shqiptarë dhe 8 maqedonas. Përpjekje të mjaftueshme 16 shqiptarë dhe 2 maqedonas, ndërsa nuk ka përpjekje për edukimin e masës për vlerat e identitetit kulturor ishin të mendimit 4 shqiptarë dhe 4 maqedonas. Do me thënë më shumë qytetarë janë të mendimit se përpjekjet janë të vogla (e paraqitur në grafikoni 4.)



Grafikoni 4.

Nga ajo që u vërejt më lartë mund të konkludojmë se mediat përpos që mundohen ta ruajnë dhe ngritin nivelin rreth ruajtjes së identitetit kombëtar, ato here-herë me ose pa dashje ndikojnë edhe në devijimin e të njëjtës, ose ngritjen e tensioneve të urrejtjes ndërnacionale në RMV përmes të plasimit të informacioneve të pa konfirmuara.

Conclusion

Based on everything discussed and the gathered material, it can be concluded that the media has had and continuous to have a great influence on all people, nations, religions and cultures. Moreover, in context of globalization, media's influence has grown remarkably. With the advancement of technology, media has evolved and expanded its role across all sectors. The speed at which the news is spread today is greatly different from the early days of the media's existence. Hatred, conflict and opposition among various national, religious and cultural groups have always existed and they continue to exist today, with the media playing role in shaping and sometimes intensifying those tensions. Regarding relationships between Albanians and Macedonians, a clear example is a survey that was done by Macedonians, in which only 20 citizens agreed on participating even though the survey was done in Macedonian language. This low level of participants clearly reflects the ongoing animosity between two communities in North Macedonia. The media fulfills its role and obligation to the public, but its influence also depends on how news is broadcasted and received. We cannot ignore the fact that the media shapes public perception, especially given its rapid development in today's era and the speed at which information spreads. This influence requires responsibility from both journalist and public, and it must be balanced within the framework of the law.

Conclusion Based on everything discussed and the gathered material, it can be concluded that the media has had and continuous to have a great influence on all people, nations, religions and cultures. Moreover, in context of globalization, media's influence has grown remarkably. With the advancement of technology, media has evolved and expanded its role across all sectors. The speed at which the news is spread today is greatly different from the early days of the media's existence. Hatred, conflict and opposition among various national, religious and cultural groups have always existed and they continue to exist today, with the media playing role in shaping and sometimes intensifying those tensions. Regarding relationships between Albanians and Macedonians, a clear example is a survey that was done by Macedonians, in which only 20 citizens agreed on participating even though the survey was done in Macedonian language. This low level of participants clearly reflects the ongoing animosity between two communities in North Macedonia. The media fulfills its role and obligation to the public, but its influence also depends on how news is broadcasted and received. We

cannot ignore the fact that the media shapes public perception, especially given its rapid development in today's era and the speed at which information spreads. This influence requires responsibility from both journalist and public, and it must be balanced within the framework of the law.

Recensentë:

Prof. dr. Ebrar Ibraimi

Doc. dr. Gjeraqina Leka

Referencat:

- Arsim Qytetar, Biljana Sh. Tatjana Gj., Shkup 2019
Centrum-2-2014, Revistë shkencore, Gëzim Xhambazi
Centrum-8-2017, Revistë shkencore, Sefer Tahiri
Gjuha e urrejtjes në mediat audiovizive, Studime dhe analiza,
Ramadan Çirupi, 2018
<https://revistashenja.com/identiteti-kombetar-shqiptar-dje-sot-dhe-neser/>
<https://revistashenja.com/tehuazimi-i-shqiptareve-ne-maqedonine-e-veriut/>
https://sq.wikipedia.org/wiki/Shqiptar%C3%ABt_n%C3%AB_Maqedonin%C3%AB_e_Veriut
<https://www.botasot.info/opinione/1379048/identiteti-kombetar-dhe-fetar-i-shqiptareve-te-maqedonise-se-veriut>
Maqedonia nuk ka vend për vetëkënaqësi, tetor 2003, Raporti i ICG-së për Evropën, N 149 Shkup/Bruksel
Prof. Dr. Kristo Frashëri, Identiteti kombëtar shqiptar dhe çështje të tjera, Titanë, 2006
Unë dhe tjetri, Zagorka Goluboviç, Beograd, 1999